



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë  
Përfaqësuesi i Lirisë së Medias**



Strasbourg, 27 shtator 2004

ATCM(2004)027 (vetëm anglisht)

## **Analizë dhe komente**

**mbi**

**projektndryshimet në Ligjin Nr. 8410, datë  
30 shtator 1998, për Radion dhe Televizionin Publik dhe  
Privat në Republikën e Shqipërisë**

**nga**

**Karol Jakubowicz**

## **Analizë dhe komente**

**mbi**

**projektndryshimet në Ligjin Nr. 8410, datë  
30 shtator 1998, për Radion dhe Televizionin Publik në  
Republikën e Shqipërisë**

**nga**

**Karol Jakubowicz\***

---

\*Drejtore i Departamentit të Strategjisë dhe Analizës,  
Këshilli i Transmetimit Kombëtar të Polonisë,  
Nënkryetar i Komitetit Drejtues të Masedias, Këshilli i Evropës

## **Parathënie**

Kjo analizë e porositur bashkërisht nga Departamenti i Medias i Këshillit të Evropës dhe Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, synon të përcaktojë nëse ndryshimet e paraqitura përputhen me standartet evropiane. Duke patur parasysh se kalimi në transmetim numerik është një proces madhor ndryshimi në transmetim dhe në zhvillimin e përgjithshëm teknologjik, duhen marrë në konsideratë edhe çështje sociale dhe kulturore që përfshihen në planet për kalimin në transmetim numerik.

## **INFORMACION BAZË**

### **Konsiderata të përgjithshme**

Shpesh ndodh që legjislacionit i duhet të ecë në një hap me zhvillimet e tregut, që ndodhin më shpejt nga sa mund të ndryshojnë kornizat rregulluese. Kështu duket se ndodh në Shqipëri, ku një operator në treg ka nisur transmetimin numerik tokësor, megjithëse ligji nuk ka dispozita lidhur me të.

Kjo krijon një mëdyshje për autoritet shqiptare. Kjo mëdyshje mund të zgjidhet vetëm duke kuptuar kompleksitetin e plotë të çështjes dhe duke shqyrtuar problemin që vjen nga një kompani që ofron tashmë shërbime numerike në kontekstin e një game shumë më të gjerë çështjesh që lidhen me politikat që ndiqen në procesin e planifikimit, përgatitjes dhe zbatimit të kalimit në transmetim numerik.

Siç është shprehur edhe Komisioni Evropian në Komunikimin për tranzicionin nga transmetimi analog në numerik (COM(2003) 541 final)

Kalimi në transmetimin numerik është një proces i gjatë dhe kompleks që përfshin shumë faktorë dhe prek pak a shumë në mënyrë të drejtpërdrejtë shumë palë, konkretisht: përdoruesit/konsumatorët, autoritetet e industrisë [së transmetimit] dhe ato publike (...) Ky kalim ka të bëjë, gjithashtu, me shumë aktorë të kësaj industrie, si krijuesit e përmbajtjes, ofruesit e shërbimit, operatorët e rrjetit apo prodhuesit e pajisjeve. Disa kanë qënë aktivë në tregun e transmetimit analog, të tjerë kërkojnë mundësi të reja biznesi. Po ashtu, departamente të ndryshme në administratat kombëtare dhe ato ndërkombëtare janë të interesuar për kalimin në transmetimin numerik për aq sa ai ndikon në arritjen e objektivave të politikave.

Komisioni Evropian paralajmëron, gjithashtu, që kalimi në transmetim numerik të mos mendohet vetëm përsa i përket transmetimit numerik tokësor.

Televizionet analoge dhe numerike ofrohen në rrjete të ndryshme, kryesisht kabllore, satelitore dhe tokësore (në bandat e frekuencave VHF dhe UHF). Përmbajtja audiovizive numerike mund të mbështetet edhe nga interneti dhe ende në masë të vogël, nga rrjetet e *linjave numerike për pajtimtarët*. Çdo rrjet ka pika të veçanta të forta dhe të dobëta. Kështu kalimi i televizionit në transmetim

numerik tokësor është një proces “multi-rrjet” ose “multi-platformë” dhe televizioni numerik nuk është sinonim i televizionit numerik tokësor.

Së fundi, Komisioni Evropian thekson me forcë se kalimi në transmetimin numerik nuk është vetëm çështje teknologjike: “Duke marrë parasysh rolin e radios dhe televizionit në shoqëritë moderne, ndikimi nuk është vetëm ekonomik, por edhe social dhe politik”.

Kështu shihet edhe nga Këshilli i Evropës, siç shprehet në Rekomandimin Rec (2003) 9 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik dhe Social të Transmetimit Numerik.

Për këtë arsye, Komiteti i Ministrave argumenton në një Shtojcë të Rekomandimeve se “do të ishte mirë nëse, para se të vazhdohej me kalimin në mjedisin numerik, shtetet anëtare, duke u konsultuar me publikun dhe industri të ndryshme të përfshira, duhej të hartonin një strategji të përkufizuar mirë, që do të siguronte një kalim të menduar me kujdes në tërësinë e tij, që mund të rriste në maksimum përfitimet dhe të minimizonte ndikimet e mundshme negative”.

#### **PËRFUNDIM**

Si çdo vend tjetër, Shqipëria ka nevojë për një strategji të plotë për zbatimin e kalimit në transmetim numerik në kontekstin e modernizimit të përgjithshëm të transmetimit dhe sistemeve të saj të komunikimit. Përgatitja e kësaj strategjie është tashmë në proces. Zgjidhja e mëdyshjes së krijuar nga një zhvillim në treg që ndodh pa një bazë ligjore nuk duhet të përjashtojë zhvillimin dhe miratimin e kësaj strategjie dhe të një plani veprimi që do të dilte prej saj.

#### **Ecuria e procesit të kalimit në transmetim numerik në vende të tjera**

Nuk ekziston një model apo formulë e vetme për kalimin në transmetim numerik. Përvojat ndryshojnë sipas rrethanave lokale dhe nga një rrjet në tjetrin. Gjithashtu, nuk ka datë të përbashkët për mbylljen e transmetimeve analoge dhe secili vend është i lirë të vendosë vetë.

Tabela 1 përshkruan ecurinë e televizionit numerik tokësor në vendet e Evropës Perëndimore.

**Tabela 1. Ecuria e Televizionit numerik tokësor (TNT) në Evropën Perëndimore**

	Legjislacioni në fuqi	Nisje e butë	Nisje e plotë	Data e mbylljes së analogut
<b>Platforma operuese</b>				
Mbretëria e Bashkuar	korrik 1996	shtator 1998	nëntor 1998	2012
Suedi	maj 1997	prill 1999	shtator 1999	2008
Spanjë	tetor 1998	maj 2000	maj 2000	2011
Finlandë	maj 1996	gusht 2001	tetor 2002	2007
Gjermani (Berlin)	pranverë 2002	nëntor 2002	3-mujori i parë i 2003-shit	vijim 2010
Holandë	1999	prill 2003	3-mujori i katërt i 2003-shit	fillon 2004
<b>Që nuk kanë filluar ende</b>				
Potugali	2000	2004	2004	2010
Zvicër	2003	2004	2005	2015
Francë	gusht 2003	2004	2005	2008+
Norvegji	mars 2002	2005	2005	Fillim 2006
Austri	2001	2005	2005	2012
Itali	nëntor 2001			2006
Danimarkë	dhjetor 2002			2011
Belgjikë	2002			2005 (Flandër)
Irlandë	mars 2001			2010

Ky informacion është marrë nga: Alexander Shulzycki (EBU) “TNT-ja në Evropë. Vëzhgim i përgjithshëm dhe vlerësim i tregut”. Tryezë e rumbullakët për TNT-në, Napoli, tetor 2003.

Datat për mbylljen e transmetimit analog duhen trajtuar si të përkoshme. Mbretëria e Bashkuar fillimisht planifikoi ta përfundonte mbylljen e transmetimit analog në vitin 2010, por megjithëse, tashmë, 55% e familjeve shohin televizionin numerik (kabllo, satelitor, tokësor), data e mbylljes së tij është shtyrë për në vitin 2012. Po ashtu, në ShBA, mbyllja e transmetimeve analoge ishte planifikuar për në vitin 2006, por tani një përpjekje për ta caktuar datën e tij për 2009 është hedhur poshtë nga Senati Amerikan si një datë shumë e shpejtë.

Shulzycki i përshkroi vendet e Evropës Lindore si ende në fazat e planifikimit dhe testimit, por asnjë prej tyre nuk ishte pranë fillimit të transmetimit. Në këndvështrimin e tij, ata hasin disa sfida të veçanta siç janë PBB e ulët për frymë dhe transmetues të dobësuar publikë.

Në qershor 2004, një Grup Pune për Televizionin Numerik Tokësor i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA) botoi raportin e tij mbi këtë temë. ([http://www.epra.org/content/english/press/papers/AGCOM\\_DTTWG\\_finalreport.pdf](http://www.epra.org/content/english/press/papers/AGCOM_DTTWG_finalreport.pdf)).

Në atë raport, vendet Evropiane ndahen në tre grupe:

- A. Vende ku TNT-ja tashmë ka nisur dhe ku rregullat dhe politikat për fillimin e TNT-së dhe procesit të kalimit në transmetimin numerik janë hartuar.
- B. Vende që janë duke u përgatitur dhe ku korniza rregullatore është në një fazë mjaft të përparuar.
- C. Vende që nuk kanë vendosur akoma një kornizë rregullatore për fillimin e TNT-së; disa prej këtyre vendeve kanë nisur studime ose kanë krijuar grupe pune për vlerësimin e mundësive të ndryshme rregullatore, ndërsa vende të tjera nuk kanë marrë ende asnjë nismë për rregullimin e procesit të kalimit në transmetim numerik në të ardhmen.

Tabela 2 tregon ndarjen e vendeve sipas grupimeve.

**Tabela 2. Zhvillimi i TNT-së në vendet e EPRA-s**

Në krye	Të ndërmjetëm	Pasues
Grupi A	Grupi B	Grupi C
Finlanda	Austria	Bosnje-Hercegovina
Gjermania	Republika Çeke	Izraeli
Italia	Danimarka	Letonia
Holanda	Hungaria	Malta
Spanja	Irlanda	Mali i Zi
Suedia	Lituania	Polonia
Zvicra	Norvegjia	Portugalia
Mbretëria e Bashkuar	Sllovakia	Republika e Maqedonisë
		Rumania
		Sllovenia

Tabela 3 paraqet datat e nisjes së TTN-së sipas raportit të studimit të EPRA-së. (shih edhe Shtojcën)

**Tabela 3. Datat e fillimit të TNT-së**

Finlanda				Gusht 2001										
Gjermania					Nënt. 2002									
Suedia		Janar 1999												
Mb. Bashkuar	Nënt. 1998													
Holanda						Prill 2003								
Italia						Dhjet. 2003								
Spanja		Tetor 1999												
Zvicra														
Austria														
Rep. Çeke														
Danimarka								Korr. 2005						
Hungaria														
Irlanda														
Norvegjia													2007	
Lituania														
Slovakia							Verë 2004							
	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	'07	'08	'09	'10	

Shënim:

Data e hyrjes në fuqi/së supozuar e nisjes

### PËRFUNDIME

1. Vetëm 8 vende evropiane raportojnë se kanë filluar me efikasitet televizionin numerik tokësor. Shumë të tjera janë akoma në fazën përgatitore dhe të planifikimit. Asnjë vend nuk është afër mbylljes së transmetimeve analoge.
2. Ndikimi financiar i TNT-së mbi transmetuesit komercialë ka të ngjarë të jetë fragmentimi i audiencës dhe humbja e reklamave në kanalet e përgjithshme; duke rritur kostot e transmetimit dhe duke çuar në rritje të të ardhurave të kanaleve tematike (reklama dhe pajtimi);
3. Kompanitë e transmetimit duhet të financojnë investime shumë të mëdha, por, në fund të fundit, mund të shpresojnë për një treg të madh potencial.
4. Prirjet e përgjithshme që kanë dalë deri tani mund të përshkruhen si më poshtë:
  - Modeli i biznesit – Është braktisur modeli i pagesës së pastër (sidomos pas falimentimit të ITV Dixhital në Mbretërinë e Bashkuar), por disa operatorë nuk kanë përqafuar ende një model krejtësisht falas.
  - Prodhuesit – që luajnë një rol më aktiv ndërkohë që ka lindur një treg i lulëzuar i dekoduesve.
  - Transmetuesit – shumë aktorë komercialë nuk janë përfshirë plotësisht. Transmetuesve publikë u është dhënë një rol drejtues, por pa financim të mjaftueshëm.
  - Industria kabllore – konkurrenca të paqarta në treg dhe rregulla detyruese.
  - Ndikimi financiar i gjerë në mbarë industrinë.

## **KOMENTE TË PËRGJITHSHME DHE VLERËSIME**

1.

Ky projektligj duket se është përgatitur posaçërisht për të zgjidhur dilemën e krijuar nga dalja e një kompanie, e cila operon me transmetime numerike tokësore pa pasur një bazë ligjore. Rregullat ligjore shpeshherë nuk ecin me të njëjtin hap me zhvillimet e tregut, kështu që, natyrshëm, kuadri ligjor nevojitet të ndryshohet, në mënyrë që të mbulojë këtë situatë të re. Problemi me këtë projektligj qëndron në faktin se nisma për të u mor nga palët e interesuara.

2.

Kalimi në transmetimin numerik është një proces kompleks, afatgjatë, që ndikon tek secili në industrinë e transmetimit dhe në të gjithë popullsinë. Shteti ka përgjegjësi për përgatitjen e një strategjie gjithëpërfshirëse për këtë kalim. Ky ndryshim do të parandalojë një pjesë të madhe të një strategjie të tillë dhe pengonte shtetin të kishte mundësi ta drejtonte procesin drejt një përfundimi të suksesshëm.

3.

Ky projektligj do të krijonte një situatë monopoli në fushën e transmetimit numerik tokësor me pajtim. Në të gjitha vendet, ku ka filluar transmetim numerik tokësor, multiplekset i janë dhënë kompanive të ndryshme, ose shoqërive të transmetuesve dhe kompanive të tjera.

Ekskluziviteti eliminon konkurrencën dhe përbën një kërcënim për pluralizmin – dhe këto janë dy qëllimet e renditura nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës përse i përket kalimit në transmetim numerik.

4.

Projektligji do të krijonte një regjim rregullues të veçantë dhe të favorshëm për kompaninë që ka licencën ekskluzive: një licencë që teorikisht ka një kohëzgjatje të pakufizuar; rinovim të licencës në bazë të kërkesës; numër të pakufizuar frekuencash për kompaninë; eliminimin e dispozitave kundër-përqendrimit për atë kompani; ndoshta një monopol mbi programet e reja të disponueshme në televizionin numerik me pagesë, si dhe mundësinë për të kontrolluar të gjithë elementet e zinxhirit të vlerave.

5. Projektligji vuan nga një sërë të metash thelbësore, të cilat renditen më poshtë:



## **REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME**

Shqipëria ka nevojë për ndryshime të Ligjit Nr. 8410, datë 30 shtator 1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë”, që do t’i shërbejnë interesit publik, të gjithë dëgjuesve dhe shikuesve, si dhe gjithë industrisë transmetuese. Ligji ka nevojë të përditësohet dhe modernizohet në shume aspekte. Këto projektndryshime nuk mund t’i shërbejnë këtyre qëllimeve.

Në këto rrethana, Kuvendi i Shqipërisë duhet të presë patjetër që qeveria dhe organet e specializuara të propozojnë një numër të gjerë ndryshimesh, të cilat do të lejojnë që vendi të ketë një kuadër rregullues transmetimi gjithëpërfshirës, modern dhe largpamës.

Në çdo sistem licencimi të krijuar nga ligji i ndryshuar, kompania që tani operon transmetimin numerik tokësor është e sigurtë – për sa kohë që ajo administrohet si duhet dhe në përputhje me ligjin – se është në gjendje të legalizojë funksionimin e saj.

Si një pionere në këtë fushë, kompania, sigurisht, meriton konsideratë, por kjo duhet të jetë pjesë dhe paketë e një zgjidhjeje shumë më të gjerë, e përcaktuar për ta përfshirë Shqipërinë në epokën numerike – një projekt madhor, që kërkon përfshirjen e shumë institucioneve dhe aktorëve të tregut.

## **KOMENTE TË DETAJUARA**

### **Neni 1**

Ky nen parashikon shtimin e një neni të ri 136/2. Ai përmban disa dispozita, të cilat duhet të diskutohen më vete.

#### 1. Përkufizimi i “programeve televizive numerike me pagesë”

Është propozuar që “programet radio televizive me pagesë” të përkufizohen si “transmetimi i zërit, figurës ose i të dyjave bashkë nepërmjet një sistemi shpërndarës të transmetimit numerik për marrje të njëkohshme të këtyre programeve nga dy ose më shumë pajtimtarë”.

## **KOMENT**

Ky përkufizim është i panevojshëm. Rregullimi duhet të jenë teknologjikisht neutral, d.m.th. rregullat duhet të jenë kryesisht të njëjta pavarësisht nga teknologjia që përdoret për shpërndarjen e përmbajtjes së programeve.

Neni 35 i ligjit përmban një përkufizim të “programeve radiotelevizive”<sup>1</sup> dhe ky përkufizim mund të zbatohet edhe për transmetimin numerik<sup>2</sup>.

Edhe më pak i justifikueshëm është përkufizimi i “programeve radio televizive numerike me pagesë”. Nëse programet janë pa pagesë, apo ofrohen me pajtim, kjo është një çështje tjetër, e ndryshme nga vetë programet.

Për më tepër, siç u vu në dukje më sipër, modeli i biznesit i transmetimit numerik nuk presupozon më që programet të ofrohen me pagesë. Nuk ka ndonjë lidhje të nevojshme midis teknologjisë numerike dhe programeve me pajtim.

Së fundi, nuk është e nevojshme që një program numerik të përkufizohet si një transmetim për “marrje të njëkohshme”. Aparatet e televizioneve numerike do të përmbajnë *hard disqe*, që do të jetë në gjendje të ruajnë shumë orë programe, kështu që një program i caktuar mund të shikohet apo dëgjohet për një kohë të gjatë pas transmetimit aktual. Këtë funksion e kryejnë sot edhe Regjistruesit Personalë Video (PVR). Një nga tiparet e transmetimit numerik është fakti që ai mund të jetë josinkron, d.m.th. përmbajtja mund të ruhet dhe të gjendet më vonë.

## PËRFUNDIM

Ky përkufizim duhet të hiqet.

## 2. Dispozita detyruese

Sipas këtij neni, “programet radiotelevizive me pagesë” përfshijnë:

1. Ritransmetimin e programeve, që jepen nga transmetues tokësorë apo satelitorë, duke përfshirë gjithmonë programe të operatorëve publikë dhe privatë.
2. Ritransmetimin e programeve të destinuara për qarqe të mbyllur televizivë.
3. Ritransmetimin e prodhimeve audiovizive të regjistruara me mjete të ndryshme.
4. Transmetimin e programeve të ndryshme të prodhuara vetë.

## KOMENT

<sup>1</sup> Do të ishte më mirë nëse do të ishte pak më preciz, si në Konventën Evropiane për Televizionin Transkufitar (neni 2 (d) “Me program do të kuptohen të gjitha gjërat brenda një shërbimi të vetëm ofruar nga një transmetues i caktuar”).

<sup>2</sup> Akti i Transmetimit i vitit 1996 i Mbretërisë së Bashkuar përkufizon “programet numerike” (Pjesa i, Seksioni 1 (4)), por kjo i referohet një “shërbimi që konsiston në ofrimin e programeve televizive (së bashku me çdo shërbim shtesë, siç përcaktohet në seksionin 24 (2) nga cilido person, me qëllim transmetimin e tyre në formë numerike për marrje të gjerë, nga ai apo persona të tjerë”, që do të thotë se ky përkufizim i referohet shërbimit të transmetimit të programeve televizive numerike dhe jo të vetë programeve.

Kjo dispozitë duket se kombinon rregullat detyruese për televizionin numerik me detyrimet e detajuara të programeve për ofruesin e shërbimit (d.m.th. operatorin multipleks)

Është e diskutueshme nëse kjo dispozitë mund të zbatohet në mënyrë strikte, sepse kjo varet nga kapaciteti i një sistemi numerik të caktuar dhe numri i kanaleve televizive që mbulohen nga ky përshkrim është potencialisht shumë i lartë.

Përshkrimi i “ritransmetimit të operatorëve publikë” si “programe radiotevizive numerike me pagesë” mund të bëhet shkak i shqetësimeve serioze, nëse kjo nënkupton se duhet të paguhet një pagesë shtesë për marrjen e këtyre programeve, të cilat transmetohen pa pagesë, dhe – si programe të shërbimit publik – në to duhet të ketë përgjithësisht gjithmonë akses.

E njëjta gjë vlen edhe për pikën e “transmetimit të programeve të ndryshme të prodhuara vetë”. Kjo do të thotë që çdo program i ri i disponueshëm në televizionin numerik mund të jetë vetëm ato që transmetohen nga operatori i sistemit. Kjo është një dispozitë kundër-konkurrencës, dhe si e tillë është e papranueshme.

#### PËRFUNDIM

Kjo pjesë e nenit ka nevojë për një rishikim të kujdesshëm dhe të plotë. Statusi detyrues për kanalet publike është i pranueshëm, por detyrimet e tjera për programet duhet të përkufizohen diku tjetër dhe jo në ligj. Asnjë pagesë shtesë nuk mund të vendoset mbi përdoruesit për të patur akses në kanalet publike. Në varësi të sistemit të zgjedhur për përdorimin e kapacitetit të *multiplekseve*, operatori duhet ose t'i trajtojë në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese të gjithë transmetuesit që duan të kenë të disponueshëm programet e tyre në *multiplex* ose duhet të parashikojë programe të përzgjedhura për *multiplexin* e veçantë nga KKRT-ja – siç parashikohet në këtë nen.

### 3. Licencë ekskluzive për programet radiotevizive numerike me pagesë

Kjo parashikon vetëm një licencë për programet numerike me pagesë, që lëshohet për një periudhë të paktën 10-vjeçare, të rinovueshme me kërkesën e zotëruesit të licensës.

#### KOMENT

Komunikata e Komisionit Evropian për kalimin nga transmetimi analog në atë numerik thotë se “Ndërhyrjet e politikave të vendeve anëtare duhet të jenë gjithashtu jodiskriminuese dhe teknologjikisht neutrale”. Ajo thotë, gjithashtu, se “zëvendësimi i transmetimit analog me një sistem të mbështetur në teknika numerike përbën avantazhe

shumë të mëdha përsa i përket përdorimit më të efektshëm të spektrit dhe mundësive më të mëdha të transmetimit; këto do të çojnë në shërbime të reja, mundësi më të mëdha zgjedhjeje për konsumatorët dhe një konkurrencë më të përmirësuar".

Në Rekomandimin Rec (2003) 9 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për Masat për Nxitjen e Kontributit Demokratik dhe Social të Transmetimit Numerik, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës:

Rekomandon që qeveritë e vendeve anëtare, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në shtojcë:

- a. të krijojnë kushte ligjore dhe ekonomike për zhvillimin e transmetimit numerik, që garantojnë pluralizmin e shërbimeve të transmetimit dhe akses të publikut në mundësi më të mëdha zgjedhjeje dhe një larmishmëri të programeve cilësore, duke përfshirë ruajtjen, dhe, aty ku është e mundur, shtrirjen e disponueshmërisë së shërbimeve transkufitare;
- b. të mbrojnë, dhe, nëse është e nevojshme, të marrin masa pozitive për të siguruar dhe nxitur pluralizmin e medias, me qëllim që të kompensojnë përqendrimin në rritje në këtë sektor.

Kjo dispozitë bie në kundërshtim me këto parime. Ajo është diskriminuese dhe kërkon të frenojë konkurrencën dhe jo ta nxisë atë. Në vend që të nxiste pluralizmin, mundësitë më të mëdha për zgjedhje, si dhe të kompensonte përqendrimin, ajo mund të ketë efektin e kundërt. Në fakt, siç do ta shohim më poshtë, ky ndryshim shfuqizon dispozitat kundërpërqendrimit të nenit 20 të ligjit 8410, datë 30 shtator 1998 "Për Radion dhe Televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", përsa i përket operatorit radioteleviziv numerik me pagesë. Kështu, po krijohet një regjim i veçantë rregullator për një operator në treg, që është më i favorshëm sesa për operatorë të tjerë.

Sipas nenit 7 (4) të këtij ligji, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit duhet "Të garantojë konkurrencë të ndershme në fushën e medias elektronike, duke siguruar në të njëjtën kohë ekzistencën dhe zhvillimin e mëtejshëm të radiotelevizionit publik shqiptar". Megjithatë, këtu, ai nuk duhet lejuar ta bëjë këtë.

Vërtetë, që kjo licencë ekskluzive do të ishte vetëm për programet me pagesë, që do të thotë se mund të jepeshin licenca të tjera për transmetimin numerik tokësor pa pagesë. Megjithatë, çdo operatori të ri që do të hynte në treg do t'i duhej të konkurronte me operatorë tashmë të konsoliduar në treg.

## **PËRFUNDIM**

Nuk ka justifikim që ligji të parashikojë vetëm një licencë të këtij lloji. Është, gjithashtu, e papranueshme që të mos përcaktohet një kufi për kohëzgjatjen maksimale të licensës. Në teori, kjo do të thotë se licenca mund të jepet për jetë. Për më tepër, nuk është e qartë se çfarë mbulon kjo licencë: vetëm ofrimin e programeve apo edhe gjëra të tjera: operimin e një multipleksi, rrjetin e transmetimit, guidën elektronike të programeve, sistemin e kushtëzuar të aksesit. Nëse është kështu, kjo licencë e vetme do të krijonte një operim të integruar vertikalisht, duke monopolizuar gjithë aspektet e shërbimeve televizive numerike me pagesë.

## **Neni 2**

Ky nen parashikon përfshirjen e nenit të ri 136/3, që mbulon licencimin dhe procedura të tjera të zbatueshme në rastin e programeve radiotelevizive numerike me pagesë.

Kushtet e specifikuar në paragrafin e dytë dhe pjesën tjetër të nenit 20 të ligjit nuk zbatohen për subjektet ligjore në fushën e veprimtarive radiotelevizive numerike me pagesë për pajtimtarët.

## **KOMENT**

Procedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licencës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licencat e transmetimeve radiotelevizive në efir të përshkruara në kreun IV të ligjit.

Neni 21 parashikon që Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit të organizojë një konkurrim kandidaturash për kërkesat e paraqitura. Në këtë rast, duket se do të ketë vetëm një kandidaturë. A mund të mbahet konkurrimi në këtë rast? Dhe nëse jo, a mund të jepet licencë?

Sipas këtij neni, KKRT-ja duhet të shpërndajë frekuencat për zhvillimin e veprimtarive radiotelevizive numerike me pagesë për pajtimtarët duke mos kufizuar numrin e tyre. A nuk do të jetë edhe ky një tjetër rast diskriminimi në favor të një operatori?

Sipas amendamentit, kushtet e specifikuar në paragrafin e dytë dhe pjesën tjetër të nenit 20 të këtij ligji nuk zbatohen për subjektet ligjore që operojnë në fushën e veprimtarive radiotelevizive numerike me pagesë për pajtimtarët.<sup>3</sup> Këto janë të vetmet dispozita të ligjit

---

<sup>3</sup> Këto dispozita janë si më poshtë:

Asnjë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, nuk duhet të ketë më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë.

Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të asamblesë së shoqërisë anonime me objekt të vetëm veprimtarinë për transmetime televizive ose radio janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 2/3 e mbajtësve të aksioneve.

Një person fizik apo juridik, që ka aksione në një shoqëri radiotelevizive kombëtare, nuk duhet të jetë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, pjesëmarrës në një shoqëri të dytë televizive ose radio kombëtare, si dhe nuk i lejohej të marrë licencë për transmetim televiziv ose radioje vendore.

Licenca për transmetim radioteleviziv lokal me modulim në frekuencë u jepet personave juridikë e fizikë të regjistruar në territorin e republikës së Shqipërisë me objekt ekskluziv veprimtarinë radiotelevizive.

Të njëjtit subjekt nuk i jepet licencë për më shumë se dy zona transmetimi vendor. Licenca për transmetim vendor në zonat urbane me mbi 200 000 banorë nuk u jepet personave fizikë.

I njëjti subjekt që zotëron një licensë për transmetim radioteleviziv lokal mund të marrë vetëm një licensë të dytë për transmetim radioje lokal.

I njëjti subjekt që zotëron një licensë për radio lokale, mund të marrë vetëm një licensë të dytë për transmetim televiziv lokal.

Mbajtësi i licensës për transmetim radioteleviziv kombëtar duhet të realizojë mbulimin e mbi 70% të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh, ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë deri në 90% të territorit dhe jo më pak se 90% të popullsisë.

të hartuara për të kufizuar dhe për të kontrolluar përqendrimet e medias. Për këtë arsye, siç u vu në dukje më sipër, ndryshimet do të krijojnë një regjim të posaçëm dhe të favorshëm për një operator.

#### **PËRFUNDIM**

Një trajtim i tillë që privilegjon një operator vështirë se mund të justifikohet.

#### **Neni 3**

Ky nen parashikon përfshirjen e nenit 136/4, duke e detyruar KKRT-në të përcaktojë rregullat dhe mënyrën e shpërndarjes së programeve radiotelevizive.

#### **Neni 4**

Ky nen parashikon përfshirjen e nenit 136/5, sipas të cilit KKRT-ja jep leje për vënien në punë të një rrjeti numerik për transmetim radioteleviziv brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve dhe pasi të jetë bërë kontrolli i zbatimit të projektit teknik dhe i pajisjeve të instaluar.

#### **KOMENT**

Siç u vu në dukje më sipër, nuk është e qartë se kujt i jepet leja. Nëse ajo do të merrej nga kompania që ka licencën ekskluzive për programe radiotelevizive numerike me pagesë, kjo do të krijonte një monopol në këtë treg.

---

Mbajtësi i licensës për transmetim televiziv ose radio kombëtare ose lokale sëhtë i detyruar të realizojë mbulimin e zonës së caktuar në licensë në përputhje me normat teknike të transmetimit.

Zbatimi i normave teknike të transmetimit monitorohet nga KKRT-ja.

Me termin “transmetim televiziv ose radio lokale” sipas këtij ligji nënkuptohet mbulimi me sinjal televiziv ose radio nga operatorët televiziv ose radio të licensuar, si të tillë, i territorit të komunave, bashkive, deri në hapësirën administrative të dy prefekturave (zona e transmetimit), kur ato formojnë një entitet gjeografik dhe që ofrojnë burime të mjaftueshme financiare për prodhim dhe transmetim programesh televizive ose radio.

i ndalohej huazimi i emrit, në çdo lloj mënyre, çdo subjekti fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që kandidohet për marrjen e një license për veprimtari radiotelevizive.

	Vendet	Shkalla e Zhvillimit të TNT-së		Shkalla e Rregullimit të TNT-së					
		Platforma numerike e hedhur ne treg	Depërtimi i TNT-së përtej %	Rregullimi për fillimin e TNT-së I hartuar tashmë	Planifikimi i frekuencës numerike i zbatuar	Kapacitetet e shpërndara operatorëve për fillimin e TNT-së	Data e fillimit të TNT-së të operatorëve publikë e vendosur	Mbyllja e frekuencave analoge e vendosur me ligj	
A	Finlandë	📶	📶	📶	📶	📶	📶	3)	A
	Gjermani	📶	📶	📶	📶	📶	📶	📶	
	Itali	📶	6)	📶	📶	📶	📶	📶	
	Holandë	📶	📶	📶	📶	📶	📶	4)	
	Spanjë	📶	📶	📶	📶	📶	📶	📶	
	Suedi	📶	📶	📶	📶	📶	📶	📶	
	Zvicër	📶	📶	📶	📶	📶	📶		
	Mb. e Bashkuar	📶	📶		📶	📶	📶	5)	
B	Austri			📶	📶				B
	Rep. Çeke								
	Danimarkë			📶	📶	📶	📶		
	Hungari	1)			📶				
	Irlandë			📶	📶	📶			
	Lituan	2)		📶	📶				
	Norvegji			📶	📶	📶	📶		
Slovaki			📶	📶					
C	Bosnje/Herc egovinë								C
	Izrael								
	Letoni								
	Maltë								
	Mali i Zi								
	Poloni								
	Portugali								
	Rep. e Maqedonisë								
	Rumani								
Sloveni									

- 1) Kanale Eksperimentale TNT të filluara në vitin 1999
- 2) Kanale Eksperimentale TNT të filluara
- 3) Të pappërcaktuara ende zyrtarisht- mendohet të fillojnë më 31.08.2007
- 4) ATO në përgatitje
- 5) Të papërcaktuara ende zyrtarisht – mund të përcaktohet gjatë 2006-2010
- 6) Depërtimi mbi 0,por nuk ka ende të dhëna të disponueshme deri në 31.12.2003